




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 345/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenković – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Aome” SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru”, me numër të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 25.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Aome” SH.P.K.– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru”, me numër të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET vendimi i AK njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim me dru”, me numër të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë dhe aktiviteti i prokurimit në fjale kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Aome” SH.P.K.– Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë me dt: 02.05.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 23.05.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar/pasuksesshëm dt: 13.06.2019

Njoftimi për dhënie të kontratës dt: 13.06.2019

Kërkesa për rishqyrtim dt: 14.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 17.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Aome” SH.P.K.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.06.2019 me nr. 345/19, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru”, me numër të prokurimit: 616-19-2765-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së:

- Shkelje e nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Shkelje e nenit 39, 41 dhe 44 të RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja Shqyrtuese në raportin e dt: 12.07.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës ka bërë shkelje të nenit 1,7,39,59,41,62,44 dhe 72, eksperti shqyrtues konstaton se këto pretendime janë të bazuara për arsye se AK Kuvendi Komunal i

Prishtinës e ka eliminuar Operatorin ekonomik me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk përputhet me çmimin e dhënë në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit Prill 2019. Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në këtë indeks ka bërë shkelje për arsye se në këtë indeks “mbledhen” të dhënat e tregut dhe nxirret mesatarja e çmimit të tregut për një periudhë kohore. Gjithashtu nëse AK bazohet në këtë indeks atëherë vlera e parashikuar e kontratës nga AK nuk do duhej të ishte 53,000.00 €. Operatori ekonomik ankues i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe çmimi i ofruar nuk e tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues nga “Aome” Sh.p.k -Prishtinë të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u cëk tek përgjigja në pretendimin nr. 1) dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 15.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues profesional, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Gashi deklaroj: Ne i kemi shfrytëzuar të gjitha mundësit ligjore kemi bërë ankese në afatin ligjor. Autoriteti Kontraktues ka kthyer një përgjigje e cila nuk është e bazuar në asnjë nen të LPP-së dhe RrUOPP-së. Raporti i Ekspertit Shqyrtues është profesional. Autoriteti Kontraktues KK-PRISHTINË ka shkelur nenin 62 të LPP-së edhe nenin 44 të RrUOPP-së, në asnjërin nga paragrafët e këtyre neneve nuk plotësohen ato arsye apo nuk e arsyetojnë anulimin e AP, gjëja se çmimet e të gjitha ofertave janë me të larta sipas Agjensionit të Statistikës së Kosovës janë me të larta se çmimet ekzistues në treg. Autoriteti Kontraktues me rastin e inicimit të këtij AP sipas vitit fiskal 2019 ka planifikuar që të shpenzojë 53,000.00 euro për këtë AP, të gjitha ofertat e dorëzuara në afatin kohor sipas njoftimit për kontratë dhe DT-së të cilat kanë qenë 5 kanë çmime me të ulëta se sa vlera e parashikuar e kontratës për këtë AP. Unë vetëm për kureshtje i kam pyetur në 3 depo për çmimet ekzistues, njëra nga to më ka dhënë çmim

37, 38 dhe 39 euro çmim për metër³ dhe nëse këtyre çmimeve ju shtohet TVSH mbërrin çmimi diku 43 - 44 euro për metër³, këtij çmimi kur i shtohet transporti, shkurtimi e tije, çmimi mbërrin diku 48 euro për metër³.

Kanë bre një shkelje të madhe të ligjit dhe sikur ky AP të anulohej dhe Autoriteti Kontraktues të iniciojë një AP të ri të prokurimit meqenëse jemi duke shkuar në sezonin e vjeshtës dhe dihet se çmimet rriten 15 deri 20% çmimi do të mbërrinte diku 54 Euro për metër³, Autoriteti Kontraktues do të obligohej të paguaj një shumë më të madhe në krahasim me ofertat e paraqitura gjatë këtij AP, por këto sipas mendimit tim arsyeja kryesore e anulimit të prokurimit ka qenë diçka tjetër“ që nuk ju ka shkrepur” që të fitoj oferta e OE të supozuar, sikur të ishte oferta e OE të preferua e Autoriteti Kontraktues sigurisht nuk do të anulohej ky AP. Në vitin e kaluar i njëjti AK çmimin për metër³ e ka paguar 48 euro për metër³.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraga deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me mendimin e Ekspertes Shqyrtuese që lënda të kthehet në rivlerësim perfektin se komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin në mënyrë proporcionale në pajtim me LPP-në mbrojtjen e parësë publike, komisioni i vlerësimit është i vetëdijshëm se vlera e parashikuar është më e lartë se çmimi i ofertave të pranuar por nuk mban përgjegjësi për vlerën e parashikuar nga njësia e kërkesë. Arsyeja e anulimit ka qenë çmimet e pranuar kanë qenë më të larta se vlera e tregut për furnizim të marrura nga statistikave të fundit nga Enti i Statistikave të Kosovës, e njëjta gjë ka ndodhur edhe vitin e kaluar kur çmimi për 1 metër³ ka qenë 35 euro. Edhe në vitin e kaluar Autoriteti Kontraktues për mbrojtjen e buxhetit ka bërë anulimin për të njëjtat kushte.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Doda deklaroj: Qëndroj prapa ekspertizës së dhënë. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Propozoj që lënda të kthehet në rivlerësim. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hidhet poshtë ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa e OE ankues kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues nga AK KK Prishtinë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës ka bërë shkelje të nenit 1,7,39,59,41,62,44 dhe 72, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se këto pretendime janë të bazuara për arsye se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka eliminuar Operatorin

ekonomik me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk përputhet me çmimin e dhënë ne indeksin e harmonizuar te çmimeve te konsumit Prill 2019. Autoriteti Kontraktues duke u bazuar ne këtë indeks ka bere shkelje për arsye se ne këtë indeks “mbledhen” të dhënat e tregut dhe nxirret mesatarja e çmimit te tregut për një periudhe kohore. Gjithashtu nëse AK bazohet ne këtë indeks atëherë vlera e parashikuar e kontratës nga AK nuk do duhej te ishte 53,000.00 €, pra vet AK e ka planifikuar këtë vlere, ndërsa Oferta e OE ankues është 48,400.00€, pra nen vlerën e parashikuar.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Operatori ekonomik ankues i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe çmimi i ofruar nuk e tejkalon vlerën e parashikuar te kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Prishtinë - Prishtinë,
- 1x1 OE – “Aome” SH.P.K. – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.